




Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	04.05.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP 03-03/1340/16
PËR/ZA/TO:	z. Nuro ISMAILI , Menaxher i zyrës së Prokurimit në Komunën e Dragashit
CC:	z. Salim JENUZI , Kryetar i Komunës së Dragashit,
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Zgjerimi i rrugës kryesore në fshatin Kuklibeg "

I nderuari z. Ismaili ,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin " Zgjerimi i rrugës kryesore në fshatin Kuklibeg" me numër të prokurimit: 621-2016-014-521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " **Zgjerimi i rrugës kryesore në fshatin Kuklibeg**" me numër të prokurimit: **621-2016-014-521**, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të ligjit nr. 05/l -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l-237.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit në tekstin e mëtejme (Agjencia) me datë 05.04.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli AKK-03-03-1340/16 për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "**Zgjerimi i rrugës kryesore në fshatin Kuklibeg**" me numër të prokurimit: **621-2016-014-521**, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Dragashit. Agjencia me datë 05.04.2016 dhe datë 12.04.2016 ka paraqitur kërkesat për dokumentacion, ku ka kërkuar nga Autoriteti kontraktues t'a dorëzojë në Agjenci tërë dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, pasi Autoriteti kontraktues të përfundojë procesin e vlerësimit të tenderëve dhe para se A.K. të bëjë njoftimin për dhënie të kontratës.

Agjencia kundër Korrupsionit, pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit, konstaton se autoriteti kontraktues ka paraparë kontratë për punë ndërtimore me vlerë të mesme të cilën e ka zhvilluar në procedurë të hapur. Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 18 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 8 prej tyre.

Agjencia pasi ka analizuar me kujdes dosjen e tenderit vëren se dosja standarde e aprovuar nga KRPP për kontratë të punëve, për këtë aktivitet të prokurimit është modifikuar në kundërshtim me ligjin. Nëse analizojmë listën e çmimeve të kësaj dosje të tenderit, vërejmë se Autoriteti ka kërkuar nga Operatorët ekonomik t'a japin çmimin për njësi dhe totalet e çmimeve. Në listën e çmimeve ka përshtetur pozicionet e punëve, njësinë matëse, sasinë, çmimin për njësi, totalet e përgjithshme. Agjencia si përfundim konstaton se nuk ka përputhje në mes listës së çmimeve nga dosja e çertifikuar në KRPP dhe listës së çmimeve në dosjen e cila i 'u është shpërndarë ofertuesve konkurrues.

Agjencia sikurse në disa aktivitete tjera të prokurimit që kanë të bëjnë me ekzekutimin e punimeve ndërtimore ka vërejtur se Autoriteti nuk ka përgatitur projektin ekzekutiv të punëve të cilat kanë për t'u realizuar me aktivitetin e prokurimit i cili është në procedurë. Specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Komuna e Dragashit në këtë rast është përgjegjëse për hartimin e projekteve ekzekutive për gjitha aktivitetet e publikuara të cilët në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjiten specifikave teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshtkrimin e hollësishëm të projektit.

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues ka konstatuar se për këtë kontratë kanë ofertuar tetë Operator ekonomik, ku sipas komisionit vlerësues të gjithë Operatorët kanë ofruar tender të përgjegjshëm. AKK pasi ka analizuar letrën standarde për tenderuesit e eliminuar dhe raportin e vlerësimit të tenderëve ka konstatuar se shumica e rubrikave të këtij raporti nuk janë plotësuar dhe si të tilla disa prej tyre kanë mbetur të zbrazëta.

Në letrën standarde për tenderuesit e eliminuar, të cilën zyra e prokurimit u'a ka drejtuar Operatorëve ekonomik të pasuksesshëm theksohet se komisioni vlerësues, pasi ka kontrolluar

dokumentacionin e këtyre Operatorëve ka konstatuar se OE Shabanaj ka dorëzuar tender të përgjegjshëm dhe ka ofruar çmimin më të ulët në krahasim me ofertat tjera, andaj komisioni vlerësues e ka rekomanduar për kontratë këtë Operator ekonomik. Në këtë leterë standarde sikurse edhe në aktivitetet tjera të prokurimit nuk janë dhënë arsyet tjera rreth plotësimit apo mos plotësimit të kërkesave të dosjes së tenderit nga ofertuesit tjerë, por i vetmi arsyetim që i është dhënë Operatorëve tjerë ka qenë se kanë ofruar çmime më të larta në krahasim me fituesin e tenderit.

Duke vepruar në këtë mënyrë Autoriteti kontraktues u ka bërë favor disa Operatorëve ekonomik duke i bërë si të përgjegjshëm, ani pse të njëjtit nuk i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe do të duhej të shpallehin si të pa përgjegjshëm.

Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes ofertat veç e veç ka konstatuar OE BRRUTI ING nuk e ka plotësuar listën e çmimeve konfrom dosjes së tenderit pjesë kjo obligative e FDT-së, pastaj nuk e ka nënshkruar dhe vulosur formularin e dorëzimit të tenderit, i mungojnë të dhënat e kompanisë, data e të dhënat tjera në FDT pjesë këto obligative të dosjes së tenderit. I njëjti Operator nuk ka plotësuar as kërkesën tek rubrika kapaciteti teknik ose profesional ku është kërkuar deklarata për caktimin e Menaxherit të projektit të njëjtit i mungon një deklaratë e tillë. Për më tepër këtij Operatori i mungojnë edhe Kontratat dhe referencat të cilat janë kërkuar në kuadër të rubrikës kapaciteti teknik ose profesional të dosjes së tenderit.

Agjencia gjithashtu ka vërejtur se edhe në një rast tjetër komisioni vlerësues ka bërë lëshime tek oferta e OE Teknika 2001 pasi që i njëjti nuk ka plotësuar kërkesën tek rubrika kapaciteti teknik ose profesional pika 1 ku është kërkuar Inxhinier i ndërtimtarisë (projekt- menaxherin). Operatori në fjalë ka ofruar diplomë me titull bachelor i ndërtimtarisë e jo me titull inxh. i ndërtimtarisë dhe arkitekturës. Agjencia konsideron se këta Operator ekonomik nuk kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit, andaj si të tillë do të duhej të eliminoheshin si të pa përgjegjshëm.

Veprimet e autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 dosja e tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike si dhe nenin 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve të ligjit për prokurimin publik Nr.04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që të mos i përsërisë dhe ti shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !